

## Bisedë me përkthyesin Robert Elsie

Robert Elsie, përkthyes i njohur i letërsisë shqipe në gjuhë të huaja, kryesisht në anglisht, ka përkthyer tash së fundi poemën epike *Lahuta e Malcis* të At Gjergj Fishtës. E përkthyer në gjuhët italiane e gjermane shumë e shumë kohë më parë, kjo vepër epike, përkthehet tashmë edhe në anglisht. Duke patur parasysh vështirësitë e padiskutueshme që dalin në përkthimin e saj në anglisht, ngaqë dihet se është fjala për një vepër thellësisht të lidhur me gjuhën dhe kulturën shqiptare, kemi bërë një bisedë të shkurtër me z. Elsie, përkthyesin e saj.

### **Pyetje: Ideja për të përkthyer Lahutën është juaja apo e sugjeruar?**

Elsie: Imja, padyshim. Por duhet thënë se nuk kanë munguar as sugjerimet. Megjithatë, me shumë se për gjithçka, është fjala për një sfidë ndaj vetës. Thoja me vete se, nëse do arrija të përktheja Fishtën, do të isha në gjendje të përktheja pothuajse çdo gjë.

### **Pyetje: Ç' të re mendoni se do t'u sjellë ky tekst lexuesve të gjuhës angleze?**

Elsie: Nuk e di.

### **Pyetje: Mos vallë këtë ndërmarrje tuajën duhet ta gjykojmë si aventurë?**

Elsie: Jo. Unë mendoj se *Lahuta e Malcis* është vepër qendrore në letërsinë shqipe. Është një vepër e rëndësishme.

### **Pyetje: Një poet i madh, Frederik Rreshpja, ka thënë se Lahuta do të kishte patur vlera të jashtëzakonshme nëse do të ishte shkruar aty nga shekulli XVI. Po ju, ç'mendoni në lidhje me këtë thënie?**

Elsie: Në të vërtetë, e pranoj se duket disi e çuditshme që kjo vepër është shkruar në shekullin XX. Besoj se është epika e fundit. Por, në fund të fundit, Shqipëria është vonë në çdo gjë. Sa herë që vij në Shqipëri nuk jam i sigurtë se në ç'shekull kam ardhur. Me këtë rast po me kujtohet dialogu që po bënin në avion një amerikan me një anglez, teksa po bëheshin gati të zbrisnin në tokën shqiptare. Amerikani e pyet anglezin, i cili ndërkohë ka qenë edhe një herë tjetër në Shqipëri: Nuk e di, a ka ndryshim ore këtu në Shqipëri. Nëse po, sa kohë duhet të lëvizë ora? Dhe anglezi i përgjigjet: dyqind vjet mbrapa! Sa i përket pyetjes suaj, mendoj se Frederik Rreshpja ka të drejtë në atë që thotë.

### **Pyetje: ka individë që kanë nënqeshur kur kanë marrë vesh se ju po përkthenit Lahutën. Kjo për faktin se Fishta është i vonuar, por edhe se ka vështirësi të jashtëzakonshme gjuhësore.**

Elsie: Po, është e vërtetë se ka shumë shumë vështirësi. Por në fund të fundit, është fjala për përkthimin e origjinalit e jo për origjinalin, i cili mbetet i pambërritshëm. Rëndësi ka që bjerrjet të jenë sa më të vogla. Por, a e dini se si thuhet në lidhje me përkthimin? Të përkthesh, në një farë mënyre do të thotë ta puthësh nusen pa ia hequr duvakun.

Intervistoi: Shpëtim Kelmendi

[Botuar në gazetën *Koha Jonë*, Tiranë, 6 nëntor 2005, f. 10 / Published in: *Koha Jonë*, Tirana, 6 November 2005, p. 10.]